



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:153971

Datë: 27.10.2022

Numri i dokumentit: 03574503

PKR.nr.160/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. S.nga fsh. L., K. S, për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.208/2022 të datës 30.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 17.10.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit B. S.dhe mbrojtësi i tij av. Muharrem Prekazi, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, te njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli me dt.**17.10.2022**, ndërsa me dt.27.10.2022, nxori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. S. i biri i S. dhe i nënës Xh., e gjinisë K. , i lindur me dt.e lindjes në fshatin L. , K. S, i identifikuar me numër personal, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me profesion pumpist, ujësjellës, posedon numër te telefonit .../...-..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, tani gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

- Më parë ka siguruar e gjer me dt. 23.07.2022, rreth orës 13:15, në sheshin “M. K.”, K. Klinë, në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr.05/L-022 për Armë, mban në posedim dhe kontroll armë, në atë mënyrë që, në kohën dhe vendin e lartcekur, policia ndalon automjetin e llojit “B...”, me targa: ...-...-..., të cilin e drejtonte i pandehuri, ashtu që gjatë legjitimitimit të të njëjtit, ndër të tjera deklaroi se ka në posedim një armë që e mbante në çantën e krahut, të vendosur në ulësen e pasagjerit, e cila pas konfiskimit ka rezultuar të jetë një (1) pistoletë e llojit “B. M.”, model, kalibër ..mm, me nr. serik: ..., së bashku me një (1) karikator dhe tre (3) fishekë, kalibër 8mm, e për të cilën armë nuk posedonte leje përkatëse.

- me çka ka kryer veprën penal, “**Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366, par. 1, të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39 par. 1 pika 1.2, 43, 69, 70, dhe neni 366 par. 1, të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së, të njëjtit, të pandehurin B. S.e:

E G J Y K O N

- I. Me dënim me gjobë në shumë të përgjithshëm prej 600 (gjashtëqind) euro, e të cilën gjobë i akuzuari ka për ti paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i akuzuari nuk e ekzekuton dënimin me gjobë, dështon apo refuzon ta paguaj, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur për një ditë burgimi vlerën nga 20 euro.
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallin gjyqësor të paguaj shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjete) euro ne emër të kompensimin të viktimave te krimit.
- IV. **KONFISKOHEN** Një (1) pistoletë e llojit “B. M.”, model ., kalibër 8mm, me nr. serik: ... dhe një (1) karikator i të njëjtës armë dhe tre (3) fishekë, kalibër 8mm, dhe të njëjtat kanë për tu **SHKATËRRUAR** pasi që aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.
- V. E të gjitha këto në afat **prej 15 (pesëmbëdhjetë)** ditësh pasi që ky aktgjykim ta merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I. Nr.208/2022 të datës 30.08.2022, kundër të akuzuarit B. S. nga fsh. L., K. Skenderaj, për shkak të veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 17.10.2022 në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Lumturije Vuçetaj dhe i akuzuari B. S. dhe mbrojtësi i tij av. Muharrem Prekazi.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit nën shenjen PP/I. Nr.208/2022 të datës 30.08.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurores së Shtetit, të akuzuarit B. S. , gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë.

Prokurorja e shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të akuzuarit B. S. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetjen në shkesat të lëndës dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Mbrojtësi i të akuzuarit B. S., av. Muharrem Prekazi, në lidhje me pranimin e fajësisë e ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, sepse është bërë pa ndikim, pa ndërhyrje të askujt dhe i propozoi gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngasë pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: Shënim zyrtar i hetuesit A. K. #.., i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-/-/..., dt. 23.07.2022; Raporti i policit A. E. #...., i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-/-/..., dt. 23.07.2022; Deklarata e të dyshuarit B. S., e dhënë pranë Stacionit Policor – Njësitit të Hetimeve - Klinë, me dt. 23.07.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-/-/..., dt. 23.07.2022; Fotografii të mjetit/armës së konfiskuar; dhe Raporti i shpejtë i policisë, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-/-/..., dt. 23.07.2022. Deklarata e të pandehurit B.S. e dhënë në Prokurori me dt. 26.08.2022; si dhe shkresat tjera të lëndës dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurorja e shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *meqenëse i pandehuri pranoi fajësinë, u vërtetua gjendja faktike siç u përshkrua në aktakuzë, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor, të dënoj sipas ligjit dhe të obligon në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, krahas dënimit kryesor ta shqipton dënim plotësues – konfiskimi i mjeteve të potencuar në aktin akuzues, gjersa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim nga ana e gjykatës si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimi i fajësisë, të cilin e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës, sjelljen korrekte në gjykatë, ndërsa si rrethana renduese gjykata ta vlerëson dhe të verifikon data bazë e të njëjtës se i njëjti a ka ndonjë aktgjykim dënues meqenëse në shkresat e lëndës keni të bashkangjitura edhe të kaluarën kriminale për të njëjtin ku i njëjti është paraqitur edhe sipas kallëzimit penal 2022-/-/... sipas stacionit Policorë në G.*

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Muharrem Prekazi në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se *duke pasur parasysh se i mbrojturi im deklaroi mbi pranimin e fajësisë e ka dhënë në bazën e konsultimit paraprak të mjaftueshëm pas shpjegimeve të marra edhe nga gjykata sa i përket benefiteve ligjore në kuptimin edhe faktik, andaj ju propozoj që të merrni parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit komfor nenit 38 të KPPRK-së, me qellim që ndaj të njëjtit të shqipton një dënim sa më të butë kjo duke marrë parasysh se në rastin konkret i pandehuri është gjykuar për të parën here nuk është*

i dënuar më parë dhe kjo paraqet si rast për të cilin ju kërkoj që të shqipton një dënim në suaza të minimaleve të dënimit të përcaktuara dhe duke marre parasysh edhe pranimin e fajësisë.

I akuzuari B. S. në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *e mbështes deklaramin e mbrojtësit tim, shprehi keqardhje për veprimet e mia, i premtoj gjykatës që nuk do ta përsëris veprimet e tilla, kjo është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, lus gjykatën që të me shqiptoi një dënim sa më të butë, i realizoj të ardhurat përfaqësisht 380 euro në muaj.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuari ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese të përcaktuara e të përmendura nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale, i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, premtimi i tij që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, ndërsa si rrethana rëndësuese gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe peshën e veprës penale.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobë u morr konform nenit 40 par. 1 pika 1.3, nenit 43 dhe nenit 366 par. 1, të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim burgimi nëse i pandehuri nuk e paguan, refuzon apo dështon ta paguaje dënimin me gjobë në afatin e caktuar u mor konform nenit 43 par. 3, të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2, pika 2.6, të KPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësuese - konfiskimin e armës dhe shkatërrimin e saj, u morr konform nenit 366 par. 3, të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.160/22 dt.27.10.2022

Bashkëpunëtorja Profesionale
Teuta Spahija

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc.Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.